



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5 regjistër (JR)
Datë 28.01.2019

Nr. 7 i vendimit
Datë 24.06.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.06.2020, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelaajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 5 (JR), datë 28.01.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shpëtim Kurti me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 80, datë 23.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 dhe neni 42 i Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 47, 51/1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi ankimin, sipas

shkaqeve të parashtuara nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 80, datë 23.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 2002 e në vijim ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë ai gëzonte statusin e magjistratit¹. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016² “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor³, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë⁴, deklaratën për kontrollin e figurës⁵ dhe formularin e vetëvlerësimit profesional⁶.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.
 - (ii) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - (iii) Është kryer fshehje e pasurisë.
 - (iv) Është kryer deklarim i rremë.
 - (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e

¹Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe prokurori, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

²Neni 279, pika 4 e ligjit 115/2016 parashikon:

“4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë [...]”.

³ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

⁴ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 23.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 23.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁵ Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 23.01.2017.

⁶ Nga provat e përcjella nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit rezulton që formulari i vetëvlerësimit profesional është dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 23.01.2017, referuar kjo raportit nr. {***} prot., datë 26.12.2017, të miratuar nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme për “Vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”.

përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport⁷ të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Ky raport, në vijim, është rishikuar dy herë nga grupi i punës, dhe i është përcjellë Komisionit, përkatësisht në datën 20.08.2018 dhe në datën 14.11.2018. Në këto raporte, ndër të tjera, është konstatuar:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka renditur në Deklaratën për Kontrollin e Figurës kontakte të papërshtatshme me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar, e kryesisht në formën e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përmbushur kërkesat e parashikuara në nenin 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 mbi rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm.
- Për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Grupi i punës gjykon se, nisur nga informacionet që disponohen për subjektin e rivlerësimit, të cilat evidentojnë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në më shumë se një rast, me shtrirje kohore relativisht të gjatë dhe aktuale, subjekti i rivlerësimit ka tendencë kriminale për t'u përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga këto struktura.
- Gjithashtu, për subjektin e rivlerësimit disponohen informacione sipas të cilave ai ka ushtruar ndikim të paligjshëm për të ndihmuar për mbylljen e çështjes penale në ngarkim të njërit prej personave me të cilin ka kontakte të papërshtatshme dhe në këmbim të sa më sipër ka marrë një sasi të caktuar parash.

Për rrjedhojë, grupi i punës ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti për vazhdimin e detyrës, konstatim të cilin e ka konfirmuar edhe në të dyja raportet e rishikuara.

5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja dhe DSIK-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në dy kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës), duke marrë vendimin nr. 80, datë 23.11.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 80, datë 23.11.2018, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
7. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej dy kriterëve të rivlerësimit.

7.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë “vetting” të pasurive në pronësi të tij dhe atyre në posedim, pasi nuk arriti të provojë dhe të japë shpjegime të besueshme mbi burimin e ligjshëm të këtyre pasurive.

7.2. Në lidhje me kontrollin e figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në nenin 38, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe kryesisht bazuar në raportin

⁷ Dërguar më datë 02.11.2017.

e DSIK-së, por edhe në dokumente të tjera, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e klasifikuar, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, konkludohet se subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

III. Shkaqet e ankimit

8. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 80, datë 23.11.2018, me pretendimin se ky është një vendim i njëanshëm, i pabazuar në ligj dhe në prova, si dhe i marrë në cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor. Subjekti pretendoi gjithashtu se vendimi i Komisionit është rezultat i zbatimit, prej këtij të fundit, në mënyrë të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sikundër dhe rezultat i një procesi të paragjykuar dhe në mungesë të analizës së provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit pranë Komisionit. Hetimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit ka qenë i cekët dhe i orientuar nga qëllimi për të përfunduar sa më parë procesin e rivlerësimit me përfundimin e paracaktuar të shkarkimit të tij nga detyra. Subjekti pretendoi se vendimi i Komisionit është marrë bazuar në fakte të pavërteta dhe të cilat nuk i përgjigjen realitetit, provave që janë paraqitur në Komision dhe të tjerave që disponohen prej tij, të cilat provojnë bindshëm fakte të cilat janë mohuar apo keqinterpretuar në vendimin objekt ankimi.
9. Subjekti i rivlerësimit ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shpresore, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 49/2012. Subjekti, bazuar në nenet 63, pika 1, 65, 66, pika 1, shkronja “b” dhe në nenin 58, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 80 vendimi, datë 23.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Shpëtim Kurti.*
 - *Vazhdimin e hetimit administrativ për të tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti.*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 80, datë 23.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti.*
10. Shkaqet e ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 10.1. *Cenim i së drejtës për t’u mbrojtur në mënyrë efektive, si pasojë e kohës jo të mjaftueshme të lënë në dispozicion nga Komisioni për njohjen me rezultatet e hetimeve, mosdhënies së provave të plota subjektit të rivlerësimit gjatë procesit dhe kufizimit të së drejtës për akses në materialet e dosjes pas dhënies së vendimit, duke cenuar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.*

10.2. *Procesi i rivlerësimit në Komision ka qenë i paragjykuar dhe vendimmarrja e tij e paravendosur, duke qenë se, përveç kohës së shkurtër nga dorëzimi i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit dhe caktimit të datës së seancës dëgjimore, në vendim nuk janë përfshirë as rezultatet e hetimit mbi kriterin e aftësive profesionale, edhe pse në fazën e dytë hetimet u rihapën për të tria kriteret e rivlerësimit.*

10.3. *Komisioni ka cenuar parimin e barazisë, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit me standarde të dyfishta, ku për çështje të njëjta ka mbajtur qëndrime të ndryshme⁸, për më tepër kur dy prej anëtarëve të trupit gjykues kanë qenë anëtarë të trupave edhe në çështjet e referuara për kriterin e pasurisë.*

10.4. *Komisioni ka cenuar procesin e rregullt nëpërmjet dhënies së një vendimi të paarsyetuar.*

10.5. *Komisioni ka cenuar parimin e pavarësisë, paanësisë së trupit gjykues dhe parimit të gjykatës së krijuar me ligj, duke qenë se dy prej anëtarëve të trupit gjykues nuk përmbushin kushtet për të qenë komisionerë, sipas përcaktimeve të nenit 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.*

11. *Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës parashtrihen në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.*

11.1. *Komisioni ka paraqitur në mënyrë të shtrembëruar situatën faktike lidhur me hetimin e kriterit të kontrollit të figurës, në drejtim të provave të administruara apo të njohura nga Komisioni dhe ONM-ja, për rrjedhojë edhe konkluzioni i Komisionit në vendim, sipas të cilit ky i fundit, në bashkëpunim me ONM-në, ka pasur akses në dokumentacionin e klasifikuar, poseduar nga institucionet verifikuese, është i pasaktë, i pambështetur në provë, fakt apo rrethanë.*

11.2. *Hetimi dhe vlerësimi i Komisionit nuk ka qenë objektiv në trajtimin e faktit të konstatuar lidhur me një sms të nisur nga shtetasi P.B., në tekstin e së cilës është përfshirë emri i subjektit të rivlerësimit dhe një numër telefoni celular.*

11.3. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me kualifikimin e shtetasit H.M. si person i përfshirë në krimin e organizuar është i pabazuar, sikundër dhe konkluzioni për deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë është i pajustificuar.*

11.4. *Komisioni nuk ka disponuar me vendim për kërkesën e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrjen në pyetje të tri shtetasve, dy prokurorëve dhe një oficeri të policisë gjyqësore, të cilët kanë hetuar dy dosjet penale mbi bazën e të cilave dhe të dhënave të tjera ishin arritur konkluzionet mbi kriterin e figurës.*

11.5. *Procedimi i shtetasit H.M. nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në vitin 2006, e përjashton atë nga kualifikimi si person i përfshirë në krimin e organizuar, duke qenë se sipas parashikimit ligjor në fuqi, personi i përfshirë në krimin e organizuar përcaktohet në raport me statusin procedural të dënimit apo procedimit të tij, për një nga veprat e parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2009, 3 vite pasi është proceduar shtetasi në fjalë.*

⁸ *Subjekti lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë referon vendimet e Komisionit: nr. 24/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit B.D., nr. 46/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit Xh.Z. dhe nr. 61/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit G.O., ndërsa sa i takon kriterit të kontrollit të figurës referon vendimet e Komisionit: nr. 79/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit E.D., nr. 62/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit A.M., nr. 47/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit A.F. dhe nr. 26/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit I.T.*

11.6. Konstatimi në raportin e DSIK-së mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme gjatë periudhës që përkon me tetor 2002 - janar 2008, bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi, sipas të cilave kontrolli i figurës bëhet brenda afatit të përcaktuar në mënyrë të shprehur nga data 01 janar 2012 deri në ditën e deklarimit.

11.7. Vendimmarrja e Komisionit, e bazuar në konkluzionin e grupit të punës në vendim, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka tendenca për t'u përfshirë [...] dhe ka më shumë se një kontakt të papërshtatshëm [...] është e pajustificuar, për sa kohë që nuk është arritur të administrohet asnjë provë në këtë drejtim, përveç një fotografie lidhur me një takim rastësor.

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

◦ Lidhur me blerjen e pasurisë “apartament banimi”, me sip. 48 m², me adresë tek “{***}”, Tiranë:

12.1. Rezultatet e pasqyruara në vendimin e Komisionit, pika 1.2, faqe 7 e tij janë të pasakta, të parashtruara si fakte në mënyrë të shtrembëruar, rezultat i një hetimi dhe analize të paplotë si dhe njëanshmërie.

◦ Lidhur me pasurinë “tokë me sip. 146 m²”, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë:

12.2. Cilësimi i z. Z.K. si “person tjetër i lidhur”, duke e ngarkuar atë me detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të pasurisë sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, tejkalon parashikimet ligjore në fuqi dhe, si rrjedhojë, hetimi lidhur me ligjshmërinë e burimit të pasurisë së z. Z.K. tejkalon objektin e procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, vendimmarrja e Komisionit e bazuar në këtë kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit është e padrejtë për subjektin e rivlerësimit.

12.3. Konkluzioni i Komisionit i paraqitur në vendim, në pikën 2, paragrafët “i”, “ii”, “iii”, në faqen 7 të tij është i panevojshëm dhe tendencioz, me qëllim rëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit dhe paraqitjen e shtrembëruar të fakteve nga ana e Komisionit.

12.4. Komisioni lidhur me trajtimin e kësaj pasurie, ka konstatuar në mënyrë të gabuar situatën faktike lidhur me punësimin e z. Z.K.

12.5. Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me pamundësinë financiare të vëllait, z. Z.K., për të financuar blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”.

12.6. Konkluzionet e aktit të përfundimit të kontrollit nga ana e ILDKPKI-së dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.11.2017, lidhur me të ardhurat e vëllait, z. Z.K., për periudhën deri në vitin 2011 dhe në vitin 2015, janë keqinterpretime tendencioze dhe janë trajtuar nga Komisioni pa asnjë hetim dhe verifikim.

12.7. Konkluzioni i Komisionit i paraqitur në vendim në pikën 2, paragrafët vii, viii dhe ix, sipas të cilit nuk ishte provuar në mënyrë bindëse as kohëzgjatja e qëndrimit të z. Z.K. në Angli, as shumat e përfituara dhe as pagesa e tatimeve që mund të legjitimonte këto të ardhura, është konkluzion i gabuar, pasi subjekti ka paraqitur mjaftueshëm prova në këtë drejtim.

12.8. Komisioni në mënyrë të gabuar ka cilësuar si “gjetje” mendimin e vëzhguesit të ONM-së, duke i paracaktuar asaj vlerën e provës në kundërshtim me parashikimet e nenit 49, pika 11 e

ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, ka gabuar në vlerësimin e çështjes mbi të ardhurat e fituara nga z. Z.K. në emigracion mbi bazën e këtij akti.

° Lidhur me kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 58000 euro:

12.9. Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me kursimet e deklaruara në vlerën 58000 euro, duke e vlerësuar këtë pasuri si deklarim të pamjaftueshëm për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur.

° Lidhur me përdorimin e apartamentit të babait të subjektit të rivlerësimit, z. M.K., pa pagesë qiraje:

12.10. Komisioni në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 ka kualifikuar si “person tjetër të lidhur” babain, z. M.K., duke i ngarkuar atij detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurisë sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe pse ai nuk ndodhet në një marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, si ato të përcaktuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar.

13. Pas depozitimit të ankimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti para Kolegjit disa kërkesa procedurale, me objekt deklasifikimin e plotë të informacionit dhe dokumentacionit të klasifikuar, njohje me dosjen gjyqësore dhe pajisje me kopje të dokumentacionit ligjor.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁹ Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 80, datë 23.11.2018, për rivlerësimin e subjektit Shpëtim Kurti, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 27.12.2018, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes më datë 28.12.2018, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 11.01.2019, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 11.01.2019, që rezulton të jetë dita e 14-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 80, datë 23.11.2018, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.
18. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimet e mëposhtme.
 - ° Lidhur me shkresën e Komisionit nr. {***} prot., datë 27.12.2018, me lëndë “Njoftimi i vendimit nr. 80, datë 23.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti”, me anë të së cilës subjekti kërkoi të provohet marrja dijeni prej tij e vendimit të Komisionit, më datë 28.12.2018, edhe pse konstatohet të jetë një akt i cili nuk mund të merrej gjatë procesit në Komision, pasi fakti që kërkohet të provohet ka ndodhur më vonë, trupi gjykues vlerësoi refuzimin e kërkesës për marrjen e kësaj prove në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Shkaku që çoi trupin gjykues në refuzimin e kërkesës për marrjen e kësaj prove, është fakti që data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit nga subjekti i rivlerësimit është e njëjtë me datën e dorëzimit të njoftimit mbi këtë vendim në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilën ka dokumentacion provues në fashikullin e Komisionit. Marrja e kësaj prove u vlerësua e panevojshme edhe për shkak se ankimi është depozituar në Komision brenda afatit ligjor dhe nuk jemi para rastit kur subjekti nevojitet të shpjegojë arsyet e mosrespektimit të afatit ligjor.
 - ° Sa u takon akteve: (i) deklaratë e datës 07.06.2018, ora 11:00, e z. Shpëtim Kurti, për njohjen me materialet e dosjes fizike dhe në formë elektronike dhe marrjen e kopjeve në variantin elektronik; (ii) deklaratë e datës 17.11.2018, ora 11:00, e z. Shpëtim Kurti, për njohjen me materialet e dosjes fizike dhe në formë elektronike dhe marrjen e kopjeve në variantin elektronik; (iii) deklaratë e datës 03.01.2019, ora 14:25, e z. Shpëtim Kurti, për njohjen me procesverbalin audio dhe të transkriptuar të seancës dëgjimore të datës 22.11.2018 dhe marrjen e kopjes së tij; dhe (iv) deklaratë e datës 07.01.2019, ora 10:00, e z. Shpëtim Kurti, për vënien në dispozicion të disa procedimeve penale – nga verifikimet e kryera rezultoi që këto akte janë pjesë e fashikullit të Komisionit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi refuzimin e kërkesës për marrjen e tyre në cilësinë e provës, në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - ° Lidhur me aktet: (i) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 02.10.2018, me lëndë “Kthim përgjigje”; (ii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 22.09.2018, me lëndë “Kthim

përgjigje”; (iii) shkresë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {***} prot., datë 01.10.2018, me lëndë “Kërkesë për informacion”; (iv) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 12.12.2018, me të cilën përcillet kërkesa e subjektit të rivlerësimit për kërkim dokumentacioni nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në përgjigje të së cilës subjekti ka marrë Aktin e Vlerësimit Profesional; (v) shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 18.12.2018, me lëndë “Kthim përgjigje”, me anë të së cilës i përcillet subjektit të rivlerësimit raporti “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti” me nr. {***} prot., datë 26.12.2017; si dhe (vi) kopje e raportit të rivlerësimit, dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 26.12.2017, nga Prokuroria Përgjithshme, drejtuar KPK-së – me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë faktin që Komisioni ka kërkuar informacion të zgjeruar lidhur me veprimtarinë e tij profesionale, edhe pse nuk ka konkluduar mbi këtë kriter dhe, për më tepër, synon marrjen nga Kolegji të këtyre provave të reja në kuadër të kërkimit të tij në ankim për rivlerësimin nga Kolegji edhe të kriterit të aftësive profesionale. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi që aktet që kërkohen të merren në cilësinë e provës, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, janë të panevojshme për vendimmarrjen e Kolegjit për sa kohë, në interpretim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji shqyrton vendimin e Komisionit mbi bazën e ankimit të subjektit, por në çdo rast, vetëm për aq kriterë rivlerësimi për të cilat Komisioni ka konkluduar në vendimin e tij, duke qenë se në referim të dispozitave të sipërcituara kushtetuese, rivlerësimi kalimtar i subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni.

° Lidhur me aktet: (i) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 12.12.2018, me lëndë “Kërkohet informacion”; (ii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. {***} prot., datë 07.12.2018, me lëndë “Kthim përgjigje”; dhe (iii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. {***} prot., datë 19.12.2018, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe subjektit të rivlerësimit për përcjelljen e kopjes së fletës së regjistrit të njoftimit të veprave penale dhe të kopjes së kartelës së përfundimit të hetimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012 – me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë faktin se, në kohën kur është realizuar takimi i subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar, sipas vendimit të Komisionit, ende nuk ishte regjistruar në regjistrin e procedimeve penale emri i personit në fjalë, trupi gjykues vlerëson se, në zbatim të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk kishte asnjë pengesë për të provuar këtë fakt gjatë hetimit në Komision. Megjithatë, në çdo rast, ky fakt është i provueshëm nga dokumentacioni i fashikullit të Komisionit dhe, për rrjedhojë, marrja e këtyre akteve në cilësinë e provave është e panevojshme, në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

° Lidhur me aktet: (i) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 12.12.2018, me lëndë “Kërkohet informacion” sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; (ii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër nr. {***} prot., datë 24.12.2018, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me lëndë “Ju dërgojmë vendimin e pushimit të procedimit penal”, bashkëlidhur vendimi i prokurorit S. B. për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2010”; (iii) kërkesë e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me lëndë “Kërkohen akte procedurale”, protokolluar me nr. {***} prot., datë 04.12.2018; dhe (iv) kthim përgjigjeje shkresës nr. {***} prot. datë 08.01.2018, nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë – me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë faktin e ekzistencës së procedimeve/kallëzimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për 2 prej anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, në kuadër të pretendimit të tij për cenim të procesit të rregullt

ligjor, si pasojë e mosformimit të rregullt të gjykatës, trupi gjykues pasi i vlerësoi aktet e mësipërme në kuadër të pretendimeve lidhur me shkakun e sipërcituar të ngritur në ankim, refuzoi kërkesën e subjektit në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi i plotë jepet më poshtë në trajtimin nga trupi gjykues të shkakut të sipërcituar të ankimit.

° Lidhur me aktet: (i) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 07.01.2019, me të cilën përcillet kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar DSIK-së për informacion në lidhje me të dhënat, informacionet dhe emrat e personave ku bazohet raporti dërguar KPK-së; (ii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 04.12.2018, me të cilën përcillet kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar DSIK-së për dokumentacion ligjor – me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë kërkesat e dështuara për marrje informacioni dhe dokumentacioni nga DSIK-ja në kuadër të pretendimit të tij për mungesë akses në informacionin dhe dokumentacionin që ka shërbyer për hartimin e raportit mbi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, trupi gjykues vlerëson si të panevojshme, në kuadër të marrjes së vendimit lidhur me çështjen, marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me DSIK-në në kuadër të së drejtës për akses, për sa kohë kjo e drejtë e subjektit të rivlerësimit, e garantuar sipas parashikimeve ligjore në nenet 4 dhe 47 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet nga Kolegji në drejtim të marrëdhënies së subjektit me Komisionin.

° Sa u takon akteve: (i) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 07.01.2019, me të cilën përcillet kërkesa për informacion e subjektit të rivlerësimit drejtuar ILDKPKI-së; (ii) shkresë e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 14.12.2018, drejtuar subjektit të rivlerësimit, me lëndë “Kthim përgjigje”; (iii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 19.12.2018, me të cilën përcillet kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar ILDKPKI-së, me lëndë “Dërgohet kërkesë për akte”; (iii) shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., datë 26.07.2018, me anë të së cilës përcillet kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar ILDKPKI-së me lëndë “Kërkohet dokumentacion ligjor”; dhe (iv) shkresë e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 03.01.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit me lëndë “Kthim përgjigje” – me anë të të cilave subjekti kërkon të provojë korrespondencën me ILDKPKI-në pas dhënies së vendimit nga ana e Komisionit, edhe pse kërkesa për marrjen e kësaj prove përmbush kërkesën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 (konstatohet që kjo korrespondencë është përcjellë edhe pranë Kolegjit dhe këto akte janë të njëjta në formë dhe përmbajtje), trupi gjykues vlerëson si të panevojshme marrjen e këtyre provave, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

° Lidhur me aktin “Fotokopje e vërtetimit nga Banka Amerikane e Shqipërisë e datës 30.10.2006, drejtuar Ambasadës së Italisë”, me anë të të cilit subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë ekzistencën e një sasive monetare, gjendje në llogari, pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, në emër të vëllait, z. Z.K., konstatohet që për të provuar këtë fakt, subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë për paraqitjen e kësaj prove gjatë fazës së gjykimit në Komision. Megjithatë, referuar dokumentacionit të fashikullit të Komisionit rezulton që ekzistenca e këtij fakti provohet nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson si të panevojshme marrjen e kësaj prove, në zbatim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

° Sa u takon akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provave të reja bashkëlidhur “Konkluzioneve përfundimtare” të dorëzuara në Kolegj, më datë 14.02.2020, trupi gjykues çmon se ato nuk përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, pasi janë dorëzuar në tejkallim të afatit brenda të cilit mund të ushtrohej ankimi ndaj vendimit objekt shqyrtimi.

19. Sa u takon kërkesave procedurale të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë Kolegjit, ato të cilat lidheshin me njohje të dosjes gjyqësore dhe pajisje me kopje të dokumentacionit ligjor të dosjes, u morën parasysh nga trupi gjykues duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u njohur me aktet e dosjes gjyqësore dhe pajisjen me dokumentacionin e kërkuar në mënyrë të shprehur prej tij. Ndërkohë, sa u takon kërkesave të subjektit të rivlerësimit që lidheshin me deklasifikimin e plotë të informacioneve dhe dokumentacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror”, të cilat janë administruar në kuadër të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe i përkasin praktikës së verifikimit dhe kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, ato u vlerësuan nga trupi gjykues si të pabazuara në ligj dhe, për rrjedhojë, u rrëzuan. Arsyet për mosdeklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar, pjesë e fashikullit të Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës së subjektit të rivlerësimit, janë dhënë në mënyrë të hollësishme më poshtë në vendim.
20. Në përfundim, trupi gjykues pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vazhdimin e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale

21. Lidhur me shkakun e ankimit për cenim të së drejtës për t’u mbrojtur në mënyrë efektive, subjekti i rivlerësimit pretendoi se atij nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme nga Komisioni për njohjen me rezultatet e hetimeve në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Subjekti pretendoi gjithashtu se nuk i janë dhënë provat e plota të administruara nga Komisioni në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, referuar këtu materialeve të procedimeve penale të cilat janë administruar nga Komisioni në kuadër të hetimit të kriterit të aftësive profesionale dhe të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, janë përdorur nga Komisioni në arritjen e vendimit për kriterin e figurës. Në kuadër të sa më sipër, subjekti pretendoi se nuk i është dhënë akses i duhur për njohjen me provat dhe të dhënat që kanë përligjur raportin për papërshtatshmërinë e figurës, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit gjyqësor, konstatoi sa vijon.

21.1. Hetimi administrativ është zhvilluar nga Komisioni në dy faza. Faza e parë e hetimit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, është përmbyllur me vendim të trupit gjykues në datën 25.04.2018. Në datën 18.05.2018, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e këtyre hetimeve dhe i është kaluar barra e provës lidhur me to, sikundër dhe i janë bërë me dije të drejtat e tij në procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve në ligjin nr. 84/2016.

21.2. Subjekti ka dorëzuar pranë Komisionit, më datë 01.06.2018, shpjegimet e tij dhe në faqen e fundit të tyre ka bërë disa parashtrime lidhur me aspektet e ushtrimit të të drejtave të tij procedurale, por nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë shqetësim për kohë të pamjaftueshme për t'u njohur me rezultatet e hetimit në këtë fazë, apo për të përgatitur shpjegimet e tij. Sa u takon provave të mbledhura nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të barrës së provës që i kaloi Komisioni, ai është shprehur: *Pasi u njoha me hetimin administrativ të bërë vetëm për pasurinë, duke qenë se ligjërisht kam barrën e provës, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të dërguar në rrugë elektronike, do të sjell dorazi pranë zyrave tuaja edhe gjithë dokumentacionin e cituar në përgjigje.*

21.3. Hetimi administrativ është rihapur më datë 04.07.2018 për të tria kriteret dhe është mbyllur nga trupi gjykues me vendimin e datës 14.11.2018. Ky vendim i është njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 15.11.2018, duke i kaluar barrën e provës për kriterin e pasurisë vetëm sa i takon çështjes së të ardhurave të vëllait dhe efektin që passolli gjetja e depozituar nga Vëzhguesi Ndërkombëtar i ONM-së lidhur me to, si dhe për kriterin e kontrollit të figurës lidhur me rezultatet e hetimit të kryer.

21.4. Subjekti në vijim paraqiti shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit, shoqëruar me dokumentacionin provues, më datë 20.11.2018. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar shqetësim lidhur me afatin kohor të pamjaftueshëm, sikundër as kërkesë për shtyrje afati. Në faqen e fundit të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Në lidhje me caktimin e datës së seancës për dëgjuesë publike të kërkuar në e-mail, e lë në disponibilitetin tuaj, duke shpresuar dhe qenë i bindur për një rivlerësim real dhe rezultat tjetër nga ai i dërguar deri tani.*

21.5. Seanca dëgjimore u caktua nga Komisioni më datë 22.11.2018.

22. Referuar sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin që Komisioni në procedurat e zhvilluara prej tij në rivlerësimin e subjektit Shpëtim Kurti, pavarësisht përcaktimit të afateve të ngushta kohore, nuk ka cenuar thelbin e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me rezultatet e hetimit për të përgatitur shpjegimet dhe për të mbledhur provat në mënyrë që të provonte të kundërtën e barrës së provës të kaluar nga Komisioni. Fakti që subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë Komisionit për kohë shtesë, u vlerësua nga trupi gjykues në drejtim të mundësisë së subjektit për të paraqitur mbrojtjen e tij brenda afateve të përcaktuara nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në prova pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, për shkak të kohës së pamjaftueshme të dhënë nga Komisioni.
23. Sa i takon pretendimit të subjektit lidhur me mosvënien në dispozicion nga Komisioni të provave të plota, nga verifikimi i akteve të fashikullit lidhur me procedurën e zhvilluar në Komision, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar "Deklaratë, datë 17.11.2018", me të cilën deklaroi se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në CD. Deklaroi gjithashtu se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialin e tërhequra në Komision, si dhe se ky dokumentacion është konform dokumentacionit të dosjeve që i janë vënë në dispozicion fizikisht pranë Komisionit dhe inventarit përkatës. Për më tepër, deklarata përmban edhe një shënim të subjektit të rivlerësimit me shkrim dore, sipas të cilit ai shprehet: *pasi të njihem me materialin e marrë në rrugë elektronike CD, nëse më nevojitet ndonjë dok. shtesë, do të drejtohem me kërkesë në adresën zyrtare. V.O. Mora fotokopje copë një nga PP nr. {***}, volumi {***}, faqe {***} sipas e-mail-it tim dhe materialit të KPK.*

24. Në vështrim të sa më sipër, duke pasur parasysh përmbajtjen e deklaratës së nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit më datë 17.11.2018 dhe shënimin në faqen e fundit të shpjegimeve të tij të dorëzuara në Komision më datë 20.11.2018, për sa kohë nuk ka asnjë dokument tjetër që të provojë ndonjë kërkesë të refuzuar për njohje apo marrje dokumentacioni, trupi gjykues vlerëson si të pabazuar në prova pretendimin e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.
25. Sa i takon çështjes së aksesit në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, nëpërmjet mosbërjes me dije të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” mbi të cilin është bazuar raporti i DSIK-së për kriterin e kontrollit të figurës dhe ai i Komisionit në marrjen e vendimit për të njëjtin kriter, trupi gjykues çmon se, me të drejtë Komisioni e ka trajtuar këtë çështje në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e GjEDNj-së¹⁰, sipas së cilës është konkluduar se nuk ka shkelje të së drejtës për proces të rregullt në drejtim të respektimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuarit për arsye të interesave të sigurisë kombëtare.
26. Gjithashtu, duke pasur parasysh vlerësimin e GjEDNj-së në vendimin *Regner kundër Republikës Çeke*, sipas të cilit [...] gjykatat kanë autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishëm të arsyeve të mbështetura nga autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ato mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim, trupi gjykues në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 20.02.2020, u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me të njëjtin informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” që lidhet me praktikën verifikuese të Shërbimit Informativ Shtetëror për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti, të cilin kishte aksesuar Komisioni gjatë hetimit administrativ. Për rrjedhojë, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se klasifikimi i informacionit të institucioneve verifikuese, në të cilat bazohen raportet e DSIK-së, është i justifikuar. Gjithashtu, trupi gjykues arrin në të njëjtin përfundim me Komisionin se: *Informacioni i klasifikuar, i verifikuar nga trupi gjykues, është në pjesën më të madhe i tillë që ekspozimi i tij do të passillte edhe ekspozimin e burimeve të informacionit (të klasifikuar), si dhe metodat e punës së institucioneve verifikuese, sikundër dhe moszbardhja e arsyetimit të plotë për vlerësimin se klasifikimi i këtij informacioni është i justifikuar, vjen si pasojë e faktit se kjo do të shkaktonte ekspozimin e informacionit të klasifikuar.*
27. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson sjelljen e Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit korrekte, për sa kohë nuk është cenuar thelbi i të drejtave të tij procedurale në kuadër të parimit të procesit të rregullt ligjor.
28. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktoritetit pasi në vendimin përfundimtar ka përdorur informacion të administruar në kuadër të hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, por i cili nuk i është bërë me dije subjektit, si dhe se pas dhënies së vendimit, Komisioni i ka kufizuar të drejtën e subjektit për njohje të plotë të të gjitha materialeve të trajtuara në vendim, duke i cenuar aksesin në gjykatë.
29. Në vlerësimin e pretendimeve lidhur me këtë shkak të ankimit, trupi gjykues mori në konsideratë komunikimet elektronike që ka pasur Komisioni me subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë çështje në datat 3 - 4 janar 2019, ku, ndër të tjera, Komisioni, në *e-mail-in* drejtuar subjektit të

¹⁰ Shih: [Regner kundër Republikës Çeke](#)

rivlerësimin më datë 04.01.2019, shprehet: *Për sa u përket dosjeve të cituara në fund të faqes 14 të vendimit nr. 80 (në nr. 5 të footnotes), ju ritheksojmë se përmbajtja e atyre dosjeve nuk është përdorur për vendimmarrje dhe as për arsyetimin e vendimit të sipërpërmendur, por citimi i tyre është kryer në funksion të transparencës lidhur me veprimet hetimore, duke listuar dosjet që lidheshin me denoncimet, por që nuk janë përdorur pasi kriteri profesional nuk ka qenë objekt i vendimmarrjes. [...] Trupi gjykues çmon se – me qëllim shuarjen e çdo dyshimi mbi mospërmbushjen e kërkesave apo të qartësimeve tuaja – në rrugë përjashtimore dhe vetëm nëse nga ana juaj do të konsiderohej ende e nevojshme – edhe pasi të keni lexuar shpjegimet e mësipërme – ju mund të paraqiteni ditën e hënë, në datën 07.01.2019, pas orës 10:30, në ambientet e KPK-së, ku mund t’ju vihen në dispozicion dosjet në fjalë [...].*

30. Referuar këtyre komunikimeve elektronike, si dhe përmbajtjes së vendimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përdorim të dosjeve penale të administruara në kuadër të hetimit të zhvilluar për kriterin e aftësive profesionale në arritjen e vendimit të Komisionit, është pretendim i pabazuar. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, nuk konstatohet asnjë fakt i referuar në vendim, i cili të burojë apo t’u referohet akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit për kriterin e aftësive profesionale.
31. Ndërkohë, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për kufizim të së drejtës për njohje të plotë me materialet e dosjes pas dhënies së vendimit nga Komisioni, nga shqyrtimi i deklaratës së nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit më datë 07.01.2019, lidhur me njohjen e akteve të dosjes bazuar në kërkesën e tij të datës 03.01.2019 dhe miratimit të Komisionit sipas tekstit të *e-mail-it* të datës 04.01.2019, si më sipër cituar, nga ku konstatohet se subjektit i janë bërë me dije të gjitha aktet e fashikullit të Komisionit, përveç materialeve të cilat janë të klasifikuara “sekret shtetëror”, përfshirë edhe pjesë të disa procedimeve penale me të njëjtin klasifikim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në prova.
32. Subjekti pretendoi në ankim se procesi i rivlerësimit në Komision ka qenë i paragjykuar dhe vendimmarrja e tij e paravendosur, duke qenë se, përveç kohës së shkurtër nga dorëzimi i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit dhe caktimit të datës së seancës dëgjimore, në vendim nuk janë përfshirë as rezultatet e hetimit mbi kriterin e aftësive profesionale, edhe pse në fazën e dytë hetimet u rihapën për të tria kriteret e rivlerësimit.
33. Lidhur me këtë shkak të ankimit, sa i takon pretendimit mbi afatin e shkurtër në dispozicion nga dorëzimi i shpjegimeve deri në datën e seancës dëgjimore, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje më sipër në vendim. Ndërkohë, lidhur me pretendimin e subjektit se vendimmarrja ka qenë e paragjykuar, si pasojë e përfundimit të procesit të rivlerësimit vetëm me dy kriteret, edhe pse hetimi u rihap për të tria kriteret e vlerësimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj dhe në prova këtë shkak. Referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Kjo dispozitë, vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni i kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, e çon trupin gjykues në përfundimin se vendimmarrja e Komisionit e marrë, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, nuk është as paragjykuese dhe as e paracaktuar.
34. Subjekti pretendoi se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit me standarde të dyfishta, ku, sipas tij, Komisioni, për të njëjtat problematika si këto të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, lidhur me dy kriteret e rivlerësimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme në vendimet për subjekte të tjera të rivlerësimit, duke mos i konsideruar

ato si shkaqe për shkarkimin e tyre nga detyra, edhe pse rezulton, sipas subjektit të rivlerësimit, se dy prej anëtarëve të trupit gjykues kanë qenë anëtarë të trupave edhe në çështjet e referuara për kriterin e pasurisë.

35. Sa i takon këtij shkaku ankimi, trupi gjykues çmon se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë dhe të cënueshëm vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, rast pas rasti dhe bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuar gjatë gjykimit dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Tashmë ky është një qëndrim i konsoliduar edhe në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit.
36. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar procesin e rregullt në drejtim të dhënies së një vendimi të paarsyetuar. Trupi gjykues i trajton pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me cenimin e standardit të arsytimit të vendimit në dritën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese¹¹, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Për shkak të natyrës së veçantë të procesit të rivlerësimit, i cili përbëhet nga vlerësimi i tri kriterëve të ndryshme dhe të pavarura njëri me tjetrin, trupi gjykues çmon ta vlerësojë respektimin e standardit të arsytimit në vendim në analizën që i bën secilit kriter të rivlerësimit.
37. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e pavarësisë, paanësisë së trupit gjykues dhe parimit të gjykatës së krijuar me ligj, duke qenë se dy prej anëtarëve të trupit gjykues nuk përmbushin kushtet për të qenë komisionerë, sipas përcaktimeve të nenit 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.
38. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmon se, për sa kohë pretendimi i ngritur lidhur me mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të dy komisionerëve, tejkalon kompetencat juridiksionale të Kolegjit dhe në kushtet që nuk konstatohen nga Kolegji, fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, pretendimi i subjektit nuk gjendet i bazuar në ligj.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

39. *Lidhur me shkakun e ankimit mbi konkluzionin e gabuar të Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës, si pasojë e paraqitjes prej këtij të fundit në mënyrë të shtrembëruar të situatës faktike mbi hetimin e këtij kriteri, në drejtim të provave të administruara apo të njohura nga Komisioni dhe ONM-ja, subjekti i rivlerësimit pretendoi se situata faktike e paraqitur në vendimin e Komisionit lidhur me këtë kriter, sipas të cilit, ky i fundit në bashkëpunim me ONM-në kanë pasur akses në dokumentacionin e klasifikuar, poseduar nga institucionet verifikuese, është i pasaktë, i pambështetur në provë, fakt apo rrethanë. Këtë pretendim subjekti e mbështet në analizën e përmbajtjes së shkresës së vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së nr. {***}, datë 11 tetor 2018, “Dokument nr. {***} bashkëngjitur Apelit Administrativ ndaj ShISH”, ku sipas tij rezulton se Shërbimi Informativ Shtetëror u ka refuzuar aksesin në informacion komisionerëve dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së.*

¹¹ *Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.*

40. Në lidhje me këtë shkak të ankimit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se më datë 08.11.2018 dhe më datë 12.11.2018, tre anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, vëzhguesi i ONM-së dhe personeli ndihmës i këtij të fundit kanë aksesuar informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” lidhur me subjektin e rivlerësimit Shpëtim Kurti pranë Shërbimit Informativ Shtetëror, provuar ky fakt sipas procesverbaleve të përpiluara për këtë qëllim dhe të nënshkruara nga të pranishmit e sipërcituar¹². Referuar datave të procesverbaleve, aksesin në informacionin e sipërcituar, të administruar nga Shërbimi Informativ Shtetëror, është realizuar në vijim të korrespondencës së referuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, mes vëzhguesit ndërkombëtar dhe Shërbimit Informativ Shtetëror, sipas shkresës nr. {***}, datë 11 tetor 2018. Për rrjedhojë, konstatimi në vendimin e Komisionit, i faktit të aksesimit të informacionit të klasifikuar lidhur me subjektin e rivlerësimit Shpëtim Kurti në ambientet e Shërbimit Informativ Shtetëror, në datat 08.11.2018 dhe 12.11.2018, është kryer në mënyrë korrekte.
41. Në vijim të procesit, në parashtrimet e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit dyshimet e tij mbi aksesin real të trupit gjykues të Komisionit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” pranë Shërbimit Informativ Shtetëror, i parashtrori në drejtim të:
- 41.1. mungesës së një akti (përgjigje, shkresë, akt administrativ apo konfirmim zyrtar nga autoriteti kompetent) të ShISh-it që lejon aksesin për këta persona;
- 41.2. mungesës së administratorëve të dosjeve në fjalë apo të punonjësve të institucionit të ShISh-it, që të kenë qenë prezent gjatë “aksesit në dosje” apo të kenë firmosur për të konfirmuar përmbajtjen e vërtetësinë e tyre;
- 41.3. faktit që procesverbalet thjesht pasqyrojnë personat që kanë firmosur dhe nuk përmbajnë, trajtojnë dhe analizojnë asgjë, apo faktit që nuk rezultojnë pasqyruar se në çfarë dokumentacioni, informacioni, fotografie, përgjimi telefonik etj., pikërisht kanë pasur “akses” trupa e KPK-së dhe përfaqësuesi i ONM-së (nëse ka ndodhur) pranë ShISh-it.
42. Lidhur me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues pasi verifikoi procedurat e ndjekura nga ana e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, gjatë procedurës së hetimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, konstatoi se: (i) aksesin e trupit gjykues të Komisionit, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga Shërbimi Informativ Shtetëror për kontrollin e kriterit të figurës, për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Kurti, është kryer me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që kanë shërbyer për arritjen e konkluzioneve të paraqitura nga grupi i punës në raportin e DSIK-së; dhe (ii) është mundësuar në sajë të kontributit të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, të cilat parashikojnë një rol aktiv të vëzhguesve ndërkombëtarë në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit.
43. Lidhur me dyshimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit mbi sigurimin e aksesit, si pasojë e faktit që në procesverbalet e datave 08.11.2018 dhe 12.11.2018 nuk përcaktohen emrat e personave që kanë administruar informacionin e aksesuar, apo të punonjësve të tjerë të institucionit përgjegjës (ShISh-it) që kanë qenë prezent gjatë kësaj procedure, sikundër dhe as të llojit konkret të burimeve të informacionit që janë aksesuar, trupi gjykues, pasi verifikoi kuadrin

¹² Shih procesverbalet e mbajtura në datat 08.11.2018 dhe 12.11.2018 në të dyja gjuhët zyrtare, f. 1562-1565.

ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e Shërbimit Informativ Shtetëror, e gjen mosparaqitjen në procesverbalet e përpiluara në datat e sipërcituara, të të dhënave lidhur me punonjësit e këtij institucioni, si dhe të burimeve të informacionit që janë aksesuar, tërësisht në përputhje me parashikimet e nenit 10 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”, i ndryshuar, sipas të cilit: *Shërbimi Informativ Shtetëror përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit [...].* Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër, vlerësohen të pabazuara në ligj.

44. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson dyshimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me faktin e konfirmuar sipas procesverbaleve të datave 08.11.2018 dhe 12.11.2018 për akses në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të pabaza. Në përfundim të analizës së mësipërme, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për paraqitje të shtrembëruar të situatës faktike lidhur me hetimin e kryer nga Komisioni dhe provat e administruara prej tij për kriterin e kontrollit të figurës, vlerësohet nga trupi gjykues si i pambështetur në prova. Për rrjedhojë, edhe shkakun i ankimit i ngritur mbi bazën e pretendimit të mësipërm, vlerësohet i pabazuar.
45. *Lidhur me shkakun e ankimit mbi hetimin dhe vlerësimin e Komisionit lidhur me faktin e konstatuar mbi një sms të nisur nga shtetasi P.B. një personi të pidentifikuar, në tekstin e të cilit është përfshirë emri i subjektit të rivlerësimit dhe një numër telefoni celular, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi i Komisionit nuk ka qenë objektiv. Sipas tij, rezultati i arritur nga Komisioni në vendimin përfundimtar: *Fakti i pretenduar/referuar nga subjekti se në Shqipëri ka 12 persona me të njëjtin emër të subjektit, nuk është bindës, për sa kohë që nuk ka elemente treguese se këta persona kanë pasur kontakte me H.M., është alogjik dhe i pambështetur në prova.**
46. Në shqyrtim të këtij shkakun të ankimit, nga vlerësimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi sa vijon.
47. Referuar akteve të fashikullit të procedimit penal nr. {***}, të regjistruar kundër personave H.M., P.B. dhe të tjerë, për veprat penale të parashikuara në nenin 298 “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe nenin 333/a “Grup i strukturuar kriminal”, rezultoi se në datën 04.03.2006, nga personi nën hetim për vepra penale të krimit të organizuar, P.B., është dërguar drejt një numri tjetër të telefonisë celulare një sms. Nëpërmjet kësaj sms-je përcillet një kontakt telefonik, i cili rezultoi të ketë emër dhe mbiemër të njëjtë me atë të subjektit të rivlerësimit, si dhe një numër të telefonisë së lëvizshme që i korrespondon kompanisë “{***}” Sh.A.
48. Referuar akteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk ka të dhëna që provojnë regjistrimin e këtij numri telefonik në emër të subjektit të rivlerësimit¹³, megjithatë nga verifikimi i të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratet e tij periodike pranë ILDKPKI-së, u konstatua nga trupi gjykues se numri i telefonisë celulare i shkruar në sms-në objekt shqyrtimi, është i njëjti numër me atë të deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në cilësinë e numrit të tij të kontaktit në rubrikat përkatëse të deklaratës së interesave privatë periodikë për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006.

¹³ *Shih përgjigjen e shoqërisë “{***}” Sh.A., datë 22.10.2018, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 22.10.2018.*

49. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se, pavarësisht se nuk ka të dhëna zyrtare të cilat të konfirmojnë përkatësinë e numrit telefonik në emër të subjektit të rivlerësimit, ky numër rezulton të ketë qenë për një periudhë kohore në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Fakti që *sms-ja* është dërguar në mars të vitit 2006, periudhë gjatë së cilës numri në fjalë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përdorim të tij, krijon bindjen te trupi gjykues se personi i përmendur në *sms-në* objekt gjykimi është vetë subjekti i rivlerësimit. Argumenti i subjektit të rivlerësimit se në gjendjen civile ekzistojnë 12 persona të regjistruar me gjeneralitetet Shpëtim Kurti, nuk gjendet bindës në vlerësimin e trupit gjykues, pasi në interpretim logjik të fakteve të sipërcituara, vetëm njëri prej këtyre 12 personave përdorte në mars të vitit 2006 numrin e telefonisë së lëvizshme që referohet në këtë *sms*, dhe ky rezulton të jetë subjekti i rivlerësimit Shpëtim Kurti.
50. Në përfundim të sa më sipër, edhe pse fakti i konstatuar mbi *sms-në* e nisur nga z. P.B., person nën hetim në atë kohë për vepra penale të krimit të organizuar, në të cilën referohej subjekti i rivlerësimit, nuk provon bindshëm ekzistencën e kontakteve të këtij të fundit me z. P.B., trupi gjykues e vlerëson këtë fakt si një indicie, e cila vlen të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të rezultateve të kriterit të kontrollit të figurës.
51. *Lidhur me shkakun e ankimit për konkluzion të pabazuar të Komisionit lidhur me kualifikimin e shtetasit H. M. si person i përfshirë në krimin e organizuar*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se vepra penale për të cilën ai është akuzuar me vendim të formës së prerë, parashikohet nga neni 298/3 i Kodit Penal, veprë e cila nuk përfshihet në veprat penale të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, referuar Kreut XI të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se nuk ishte në gjendje të parashikonte se ç'do të ndodhte me z. H.M. në të ardhmen dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit mbi pasaktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit është i pajustificuar për shkak se, në kohën e takimit me këtë person, ai nuk ka pasur asnjë procedim penal të regjistruar në ngarkim, nuk është marrë në pyetje me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, nuk ka pasur asnjë masë sigurimi personal që provon atribuimin e veprës penale, nuk ka pasur njoftim akuze, dhe atribuimi i veprës penale z. H. M. nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, i është bërë në momentin e kërkesës për caktim mase sigurimi, e cila është ekzekutuar më datë 29.03.2013, rreth 1 muaj më vonë nga takimi rastësor me subjektin e rivlerësimit.
52. Në vendimin e Komisionit lidhur me konstatimin e vendosjes së një kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar arsyetohet:
- (i) *Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm, theksohet që shtetasi H. M. - për të cilin subjekti ka pohuar që e njeh dhe që e ka takuar, sipas tij në mënyrë rastësore - ka qenë i proceduar penalisht, më datë 9 janar 2006, nga Prokuroria e Krimeve të Rënda - procedimin penal nr. {***}, në bazë të nenit 298 të Kodit Penal: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe neni 333/a të Kodit Penal: “Grup i strukturuar kriminal” kundër H. M., P. B. dhe personave të tjerë.*
- (ii) *Edhe pse, në një moment të dytë, akuza në bazë të nenit 333/a të Kodit Penal është rrëzuar nga vetë Prokuroria e Krimeve të Rënda – por jo me një vendim gjyqësor pafajësie të formës së prerë – cilësimi i shtetasit H. M. si një “person i përfshirë në krimin e organizuar”, rezulton të jetë në përputhje me pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.*
53. Në vlerësim të këtij shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se:

53.1. Në datën 09.01.2006, Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. {***} në ngarkim të shtetasve H. M. dhe personave të tjerë për veprën penale “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit”, të kryer në bashkëpunim në formën e “grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal.

53.2. Në datën 29.06.2007, është shpallur moskompetenca lëndore lidhur me hetimet e këtij procedimi penal dhe kalimi i akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vijimin e hetimit në ngarkim, ndër të tjerë, të H. M.-së për elementet e veprës penale të “Ndhimës për kalim të paligjshëm të kufirit në bashkëpunim e më tepër se një herë”, e cila me datë 10 janar 2008 ka pushuar procedimin penal ndaj shtetasit H.M.

53.3. Në datën 24.12.2012, Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. {***} për veprën penale “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit”, të kryer në bashkëpunim në formën e “grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal, ku ishte sërish i përfshirë, ndër të tjerë, edhe shtetasi H.M. Në datën 26.09.2013, është shpallur moskompetenca lëndore nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda lidhur me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2012, dhe aktet i janë përcjellë për rrjedhojë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

53.4. Në datën 02.06.2015, H.M. është dënuar nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit”, të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, me 5 vite burg, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

- 54.** Referuar sa më sipër, në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni përfshirjen e z. H.M. në krimin e organizuar nuk e ka lidhur me faktin që ai është dënuar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, por me faktin që i njëjti person është proceduar në vitin 2006 për veprën penale të parashikuar nga neni 333/a, dispozitë e përfshirë në gamën e veprave penale të përcaktuara shprehimisht në nenin 3, pikat 8 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar. Ky procedim penal në ngarkim të z. H.M., edhe pse është pushuar në vijim, referuar parashikimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, nuk ndikon në vlerësimin e përfshirjes në krim të organizuar, për sa kohë personi në fjalë nuk rezulton të jetë deklaruar, në vijim, i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë për akuzat e ngritura ndaj tij. Trupi gjykues, në këto kushte, çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni lidhur me përfshirjen e z. H.M. në veprimtari të krimit të organizuar është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe, për rrjedhojë, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim nuk gjendet i bazuar.
- 55.** Përveç sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë edhe një tjetër fakt, të konstatuar edhe në vendimin e Komisionit, sipas të cilit z. H.M. është dënuar me burgim, me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, për veprën penale të “Falsifikimit të monedhave”, të parashikuar nga neni 183/2 i Kodit Penal, dispozitë kjo e përfshirë në gamën e veprave penale të përcaktuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, çka përforcon bindjen e trupit gjykues se vlerësimi i Komisionit për cilësimin e H.M.-së si person i përfshirë në krimin e organizuar, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova.

56. Në shqyrtim të pretendimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me faktin se në momentin e takimit, sipas tij, “rastësor” me personin H.M, ky i fundit nuk figuronte ende person nën hetim dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk kishte se si të parashikonte se ç’do të ndodhte me të në të ardhmen dhe këtë fakt të mund ta deklaronte në deklaratën e kontrollit të figurës, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se, referuar akteve të fashikullit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2013, procedimi penal nr. {***} i vitit 2013, në ngarkim të shtetasve H.M e të tjerë që hetohen për veprat penale të “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve”, në bashkëpunim më shumë se një herë”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, është përcjellë për kompetencë hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda te Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 30.09.2013. Ky procedim penal i regjistruar pranë kësaj të fundit me nr. {***}, datë 01.10.2013, i ka kaluar për trajtim nga drejtuesi i prokurorisë në datën 01.10.2013 subjektit të rivlerësimit, me urdhërimin: *z. Kurti! Të caktohet një prokuror për të hetuar çështjen*¹⁴.
57. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se të paktën në datën 01.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni të plotë dhe në mënyrë zyrtare lidhur me statusin procedural/penal të personit me të cilin ishte takuar, përfshirë këtu edhe vendimin e prokurorit të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë A.C., të datës 15.02.2013, për pushimin e ekzekutimit të dënimit alternativ për të dënuarin H.M., sipas të cilit provohet se H.M. ishte dënuar me burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 183/2 i Kodit Penal “Falsifikim monedhash” (akt ky pjesë e fashikullit të procedimit të sipërcituar penal). Referuar sa më sipër, në kohën e takimit me subjektin e rivlerësimit, shtetasi H.M., përveçse i përfshirë në hetime, sipas procedimit penal nr. {***}, rezulton të ketë qenë edhe i dënuar penalisht për një tjetër vepër të rëndë penale dhe ky fakt, në datën e plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës, çmohet të ketë qenë i njohur për subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit si më sipër nuk përmbush kriteret e besueshmërisë për t’u vlerësuar si rrethanë lehtësuese në kuadër të parashikimeve të nenit 38, pika 7, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.
58. *Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit Komisioni nuk ka disponuar me vendim për kërkesën e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrjen në pyetje të tre shtetasve, dy prokurorëve dhe një oficeri të policisë gjyqësore, të cilët kanë hetuar dy dosjet penale mbi bazën e të cilave dhe të dhënave të tjera ishin arritur konkluzionet mbi kriterin e figurës, trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në kuadër të kalimit nga Komisioni të barrës së provës, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e kontrollit të figurës, më datë 15 nëntor 2018, është shprehur:*
- [...] **Së pesti**, në lidhje me dosjen nr. {***} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor [...] Sjell në vëmendjen tuaj se në regjistrin kombëtar të gjendjes civile me emrin Shpëtim Kurti janë të paktën mbi 12 shtetas, jam plotësisht i sigurt që nuk kam asnjë implikim apo njohje me asgjë, ndaj kërkoj që në lidhje me këtë informacion, nëse gjykohet e nevojshme, të merret e të pyetet prokurori i çështjes, i cili duhet të sqarojë gjithçka nëse nga ana ime është tentuar apo është ndërhyrë për të influencuar në lidhje me ndonjë person të mundshëm.
 - [...] **Së teti**, për pjesën e arsytuar për llojin dhe masën e dënimit të kërkuar ndaj të pandehurve, përfshirë edhe shtetasin H.M., dua të saktësoj se pas riorganizimit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, prokurori i çështjes së shtetasit H.M., nuk ka qenë më pjesë e grupit të prokurorëve që ishin në linjën që drejtoja unë [...]. Gjithashtu kërkoj nga ana juaj, që nëse e çmoni të arsyeshme, të thirret e të pyetet si dëshmitar prokurori i çështjes, e

¹⁴ Shih shënimin me shkrim dore në pjesën e sipërme, në anën e majtë të shkresës nr. {***} prot., datë 30.09.2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

të japë sqarime nëse është ndikuar nga ana ime në lidhje me hetimin e kësaj çështjeje, në të gjitha fazat e tij.

59. Në vlerësim të sa më sipër deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, kërkesa e tij për marrjen e provës me dëshmitarë, përveçse është lënë në çmimin e trupit gjykues të Komisionit, mbi të gjitha i referohet rezultatit paraprak të hetimit të Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës “*dyshimit për ushtrim të ndikimit të paligjshëm gjatë kryerjes së detyrës*”. Nga verifikimi i konkluzioneve të Komisionit në vendim lidhur me këtë kriter, trupi gjykues konstaton se dyshimi i ngritur fillimisht në rezultatet e hetimit paraprak lidhur me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e çështjeve penale ku ka qenë i përfshirë shtetasi H.M., nuk është ngritur në nivel konkluzioni përfundimtar, vlerësim që Komisioni e ka bërë në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë dhe vetë subjekti. Në këtë kuptim, marrja e kësaj prove me dëshmitarë ka qenë e panevojshme për arritjen e vendimit të Komisionit dhe, për rrjedhojë, mosmarrja e saj nuk mund të cenojë vendimin e këtij të fundit. Ndërkohë, sa i takon mosdisponimit në vendimin përfundimtar, në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit duke argumentuar shkaqet e refuzimit, të cilat në këtë rast bazohen në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se ky moment është trajtuar në kuadër të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke u korrigjuar përmes arsyetimit të mësipërm në vendimin e Kolegjit.
60. *Lidhur me shkaku e ngritur në ankim për konkluzion të gabuar të Komisionit në lidhje me cilësimin e shtetasit H.M. si person i përfshirë në krimin e organizuar, në argumentim të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se fakti që shtetasi H.M. është proceduar nga Prokuroria për Krime të Rënda në vitin 2006, e përjashton atë nga kualifikimi si person i përfshirë në krimin e organizuar, duke qenë se sipas subjektit të rivlerësimit, referuar parashikimit ligjor në fuqi, personi i përfshirë në krimin e organizuar përcaktohet në raport me statusin procedural të dënimit apo procedimit të tij për një nga veprat e parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2009, 3 vite pasi është proceduar shtetasi në fjalë.*
61. Në shqyrtim të këtij shkaku të ankimit, trupi gjykues fillimisht konstaton se, pavarësisht se subjekti ngre një pretendim në drejtim të mosplotësimin të një kriteri formal, sipas të cilit përfshirja në krimin e organizuar përcaktohet në referencë të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, i cili në kohën e regjistrimit të procedimit penal ndaj shtetasit H.M. në vitin 2006, nuk ka qenë në fuqi, është fakt që çështjet objekt të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, në atë periudhë rregulloheshin nga ligji i kohës nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i ndryshuar, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se përfshihej¹⁵ dhe vepra penale e parashikuar në nenin 333/a të Kodit Penal, për të cilën është proceduar z. H.M. në vitin 2006. Në analizë të legjislationit të zbatueshëm që rregullon çështjen e përcaktimit të përfshirjes në krimin e organizuar, duke interpretuar në mënyrë logjike dhe sipas qëllimit të legjislatorit parashikimin e paragrafit 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se analiza juridike për përcaktimin e përfshirjes së një personi në krimin e organizuar, duhet të kryhet e lidhur ngushtësisht me llojin e veprës penale të konsumuar prej tij dhe vlerësimin nëse kjo vepër përfshihet në gamën e veprave të përcaktuara shprehimisht në

¹⁵ Shih nenin 3, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i ndryshuar.

nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 10192, datë 03.12.2009”), në momentin kohor kur kryhet vlerësimi nga trupi gjykues mbi ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit me këtë person. Kjo nënkupton që përfshirja në rrethin e subjekteve sipas përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të vlerësohet në raport me datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, dhe eventualisht në lidhje me procedimet penale apo vendimet penale, të cilat janë regjistruar/dhënë pas këtij momenti kohor, pasi një vlerësim i tillë më së paku do të passillte trajtim të ndryshëm të subjekteve të rivlerësimit për kontakte me persona të cilët kanë kryer vepra të njëjta penale për nga rëndësia, por procedimet/dënimet janë regjistruar/dhënë në kohë të ndryshme në raport me momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009.

62. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim mbi konstatimet në raportin e DSIK-së mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme gjatë periudhës që përkon me periudhën kohore tetor 2002 - janar 2008, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendoi se këto konstatime bien ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi, sipas të cilave kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe afateve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, i cili është, sipas subjektit të rivlerësimit, nga data 01 janar 2012 deri në ditën e deklarimit.
63. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, në referim të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore në zbatim të të cilave zhvillohet procesi i rivlerësimit, konkretisht nenit Ç, pika 1 dhe nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se kriteri kohor i përcaktuar në mënyrë të shprehur në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, i referohet vetëm detyrimit për plotësimin e deklaratës së detajuar për figurën dhe deklarimit në këtë kuadër, me saktësi dhe në përputhje me rubrikat përkatëse të saj, të çdo informacioni, të dhëne apo rrethane të ndodhur apo kërkuar brenda këtij afati kohor. Vetë përcaktimi i këtij afati me pikënisje datën 1 janar 2012 dhe pikë fundore datën e deklarimit sipas ligjit, konfirmon më së miri se, në lidhje me këtë periudhë kohore, do të vlerësohet saktësia dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme. Duke qenë se referuar pikës 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kjo deklaratë ka vlerën e provës në këtë proces dhe se deklarimi i pasaktë sjell pasoja për subjektet e rivlerësimit, legjislatori ka përcaktuar për këtë qëllim një afat të arsyeshëm e të përshtatshëm kohor për subjektet e rivlerësimit për të përmbushur një detyrim, i cili lidhet në mënyrë të pashmangshme me kujtesën. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj këtë shkak të ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit.
64. Sa i takon shkakut të ankimit për vendimmarrje të pajustificuar të Komisionit, si pasojë e faktit që vendimi në fjalë është bazuar në konkluzionin e grupit të punës së DSIK-së, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit ka tendencë për t'u përfshirë në krimin e organizuar [...] dhe ka më shumë se një kontakt të papërshtatshëm [...]*, por në mbështetje të këtij konkluzioni nuk është arritur të administrohet asnjë provë, përveç një fotografie lidhur me një takim rastësor, trupi gjykues pasi shqyrtoi përmbajtjen e vendimit të Komisionit konstatoi se togfjalëshi *subjekti i rivlerësimit ka tendencë për t'u përfshirë në krimin e organizuar [...]* është referuar në vendim në faqen 13 të tij, në atë pjesë të vendimit që referon rezultatet e raportit të DSIK-së, të deklasifikuar pjesërisht më datë 29 mars 2018. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit verifikohet fakti i kryerjes së hetimeve nga ana e Komisionit në drejtim të verifikimeve të rezultateve të raportit të DSIK-së, të cilat në vijim janë vlerësuar nga Komisioni në kuadër të rezultateve të hetimit të tij, përmendur në mënyrë të hollësishme edhe në vendim, si dhe shpjegimeve të subjektit dhe provave të

dorëzuar prej tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit se vendimmarrja e Komisionit është bazuar në konkluzionin e grupit të punës, është i pasaktë, fakt ky që konfirmohet edhe nga konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me këtë kriter, ku ndryshe nga sa konstatohet në raportin e DSIK-së, Komisioni nuk ka konkluduar mbi tendencat kriminale të subjektit të rivlerësimit për t'u përfshirë në krimin e organizuar, por vetëm në drejtim të vënies në presion nga këto struktura kriminale.

65. Sa i takon pretendimit lidhur me mungesën e provave që mbështesin konkluzionin e Komisionit, përveç ekzistencës së një fotografie lidhur me një takim rastësor, trupi gjykues çmon të theksojë faktin se Komisioni ka krijuar bindjen mbi ekzistencën e problemeve serioze të subjektit të rivlerësimit, edhe në saje të aksesimit të informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga ShSh për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti.
66. Në kontekst të sa më sipër, në kuadër edhe të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, sipas të cilit *gjykatat kanë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara në të cilat autoriteti është bazuar vetë në mënyrë që të justifikojë vendimin e tij*, me qëllim kontrollin e vendimmarrjes së Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues me vendimin e ndërmjetëm të datës 20.02.2020, vendosi të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të gjithë dhe të njëjtin informacion që i është vënë në dispozicion trupit gjykues të Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, në datat 08.11.2018 dhe 12.11.2018. Njohja me provën e administruar gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbart dhe kushteve specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror më datë 05.03.2020.
67. Trupi gjykues, pasi verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar edhe nga Komisioni, verifikoi vërtetësinë e burimeve të informacionit që ka shërbyer për hartimin e raportit të Grupit të Punës pranë DSIK-së, si dhe vlerësoi arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumentacionit të klasifikuar dhe dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me të, subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin se vendimmarrja e Komisionit në këtë drejtim është e drejtë dhe e justifikuar. Më konkretisht, trupi gjykues e gjen plotësisht të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni në vendim: *[...] Trupi gjykues ka konstatuar se ka tregues të fortë se kontaktet ndërmjet subjektit dhe shtetasit H.M. kanë qenë disa, jorastësore dhe të papërshtatshme. Subjekti pranon vetëm një kontakt, të cilin ai e cilëson si të rastësishëm, ndërkohë që është konstatuar fakti se në të vërtetë ka pasur më shumë kontakte midis tyre dhe të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë, që nuk mund të konsiderohet si një rastësi.*
68. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen lidhur me ekzistencën e problemeve serioze të subjektit të rivlerësimit gjatë kontrollit të figurës së tij, sipas parimeve të përcaktuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, shkaqet e ngritura në ankim lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, çmohen si të pabazuara në fakte, në prova dhe në ligj dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter të rivlerësimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, gjendet i drejtë dhe i bazuar. Për më tepër, Kolegji gjen me vend të mbështetë arsyetimin e Komisionit në vendim, sa i takon ligjshmërisë së përdorimit të informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” në vlerësimin e këtij rasti, si dhe lidhur me vlerësimin se klasifikimi i informacionit të aksesuar nga trupi gjykues i Komisionit

dhe i Kolegjit, është plotësisht i justifikuar. Në këto kushte, rezultatet e kontrollit të kriterit të figurës, referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, passjellin zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

69. *Lidhur me blerjen e pasurisë “apartament banimi”, me sip. 48 m², me adresë tek “{***}”, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se rezultatet e pasqyruara në vendimin e Komisionit, pika 1.2, faqe 7 e tij, janë të pasakta, të parashtruara si fakte në mënyrë të shtrembëruar, rezultat i një hetimi dhe analize të paplotë, si dhe njëanshmërie të treguar në vijim nga Komisioni, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.*
70. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim:
1.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm
Në vijim të sa më lart është pasqyruar¹⁶, mbi problematikat e kësaj pasurie, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën “vetting” - nisur nga fakti që është përshkruar një sipërfaqe toke e ndryshme krahasuar me atë që ai dhe familjarët e tij posedojnë de facto.
71. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e Komisionit me pretendimin se ky i fundit ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me deklaramin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting* mbi sipërfaqen e pasurisë “tokë arë” në fshatin {***}, duke e vlerësuar këtë si deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi në deklaramin fillestar në vitin 2003 të kësaj pasurie, sipërfaqja e deklaruar i referohet sipërfaqes reale në terren dhe jo asaj të pasqyruar në Aktin e Marrjes së Tokës në pronësi (AMTP), ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar sipërfaqja sipas AMTP-së dhe është dhënë sqarimi lidhur me mospërputhjen që ekziston mes sipërfaqes së kësaj toke në aktin ligjor dhe asaj të përcaktuar në terren.
72. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton fillimisht që Komisioni konkluzionin e sipërcituar e ka dhënë në kuadër të hetimit të zhvilluar në lidhje me blerjen e apartamentit me sipërfaqe 48 m², me vendndodhje në “{***}”, Tiranë (një ndër pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*) dhe jo në kuadër të vlerësimit të krijimit të pasurisë “tokë arë”, me vendndodhje në fshatin {***}, edhe kjo pasuri e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*.
73. Referuar arsyetimit në vendimin e Komisionit, sipas këtij të fundit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë “apartament banimi” tek “{***}”, si pasojë e deklaramit të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin të sipërfaqes së pasurisë “tokë bujqësore” në fshatin {***}, Has.
74. Ndonëse subjekti i rivlerësimit pretendimin e tij e lidh vetëm me mënyrën e deklaramit të pasurisë “tokë bujqësore”, pasuri e veçantë dhe pjesë e pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*, është e paqartë për trupin gjykues se si Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë “apartament banimi”, si pasojë e deklaramit jo të saktë të pasurisë tokë bujqësore. Komisioni nuk ka paraqitur në vendim analizën ligjore, e cila e ka çuar në arritjen e këtij konkluzioni, bazuar në faktet e

¹⁶ Shprehja “sa më lart është pasqyruar” u referohet gjetjeve nga hetimi i kryer lidhur me blerjen e pasurisë “apartament banimi” tek {***} në Tiranë dhe qëndrimin të subjektit lidhur me rezultatet e hetimit mbi këtë pasuri.

konstatuara dhe të evidentuara ne vendimin e tij¹⁷, lidhur me trajtimin e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi”, me sipërfaqe 48 m², me vendndodhje në {***}, Tiranë.

75. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi me rëndësi analizimin e çështjeve të mëposhtme.
- (i) Nëse mospërputhjet në deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me sipërfaqen e pasurisë “tokë bujqësore”, e bëjnë deklarinin e tij për këtë pasuri të pasaktë dhe të pamjaftueshëm?
 - (ii) Nëse një deklarinim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm lidhur me pasurinë “tokë bujqësore” mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë “apartament banimi” tek “{***}”?
76. Sa i takon çështjes së parë, referuar deklarinimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003 dhe deklarinimit të kryer në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me pasurinë tokë bujqësore, konstatohet të ketë mospërputhje në deklarinim lidhur me sipërfaqen e kësaj pasurie. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, sipërfaqja e pasurisë në fjalë në deklaratën e pasurisë *vetting* përputhet me sipërfaqen sipas aktit ligjor, me të cilin subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, është bërë bashkëpronar i pasurisë në fjalë. Gjithashtu, rezulton që subjekti të ketë deklaruar edhe faktin që në realitet pasuria në fjalë ka një sipërfaqe më të madhe se ajo e cilësuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, të datës 01.01.1995, të fshatit {***}, Has. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se përcaktimi në vendimin e Komisionit, në paragrafin 1.2 të tij (shih paragrafin 70 më sipër në vendim), se subjekti i rivlerësimit ka përshkruar një sipërfaqe toke të ndryshme krahasuar me atë që ai dhe familjarët e tij posedojnë *de facto*, nuk është plotësisht i saktë, për sa kohë subjekti ka deklaruar që sipërfaqja reale është më e madhe se ajo sipas aktit ligjor. Fakti që pasuria në fjalë është ende e paregjistruar pranë regjistrit të pasurive të paluajtshme, e bën të pamundur për trupin gjykues verifikimin e sipërfaqes reale të kësaj toke dhe vlerën e mospërputhjes së saj me sipërfaqen e dhënë sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe, për pasojë, gjithçka mbetet në vlerësim të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarinimeve të vetë subjektit të rivlerësimit përkatësisht në vitin 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.
77. Ndërkohë, sa u takon mospërputhjeve të konstatuara në deklarinimet e subjektit lidhur me sipërfaqen e kësaj toke bujqësore, trupi gjykues çmoi se ato nuk mund të prodhojnë pasojat e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga hetimi i kryer në Komision nuk është konstatuar që sipërfaqja më e madhe e poseduar *de-facto* dhe e deklaruar nga subjekti në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting* (si fakt që sipërfaqja reale është më e madhe se ajo e përshkruar në AMTP) vjen si rrjedhojë e rasteve të parashikuara në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, paragrafët nga “b” në “d” të ligjit nr. 84/2016.
78. Në kuadër të analizës lidhur me çështjen e dytë për trajtim, që i referohet lidhjes mes tokës bujqësore dhe problematikave potenciale në deklarinimin e saj dhe vlerësimit të krijimit të pasurisë “apartament banimi” tek “{***}”, trupi gjykues konstatoi se toka bujqësore në fshatin {***}, Has, pasuri e veçantë në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së llojit apartament banimi tek “{***}”, duke qenë se për këtë arsye janë përdorur të ardhurat e shitjes së apartamentit të blerë në vitin 2002 në Kukës nga EKB (në saje të përfitimit nga subjekti i rivlerësimit të statusit “i pastrehë”). Për rrjedhojë, lidhja e kësaj pasurie (tokës bujqësore) me apartamentin e blerë në Kukës nga EKB-ja ekziston si pasojë e pengesës ligjore që kishin familjet e pastreha për të përfitur nga statusi “i të pastrehëve” në rastin që ata kishin

¹⁷ Shih paragrafët 1 dhe 1.1 të vendimit të Komisionit, në f. 5 dhe 6 të tij.

përfituar tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”. Thënë ndryshe, ekzistenca e pasurisë “tokë bujqësore”, pavarësisht sipërfaqes së saj dhe rrjedhimisht dhe mospërputhjeve lidhur me të, në një vlerësim të parë mund të krijonte probleme lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së pasurisë së blerë nga EKB-ja, duke i transferuar këto problematika edhe në të ardhurat e krijuara nga shitja e saj në vijim, të cilat rezultojnë të kenë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi tek “{***}”. Trupi gjykues konstaton se një konkluzion i tillë nuk është arritur në vendim nga Komisioni.

79. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur nga Komisioni në paragrafin 1.2 të vendimit është i paqartë, i paarsyetuar dhe, për sa kohë e lidh pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë “apartament banimi” tek “{***}” me mospërputhjet në deklarime të sipërfaqes së pasurisë “tokë bujqësore” vlerësohet edhe si një konkluzion i gabuar.
80. *Lidhur me vlerësimin e pasurisë “tokë me sip. 146 m²” me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë kësaj pasurie të paluajtshme, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.*

80.1. Cilësimi i z. Z.K. si “person tjetër i lidhur”, duke e ngarkuar atë me detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të pasurisë sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, tejkalon parashikimet ligjore në fuqi dhe, në këtë kuptim, hetimi lidhur me ligjshmërinë e burimit të pasurisë së z. Z.K. tejkalon objektin e procesit të rivlerësimit. Për pasojë, sipas subjektit të rivlerësimit, edhe vendimmarrja e Komisionit e bazuar në këtë kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit, është e padrejtë për subjektin e rivlerësimit.

80.2. Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me pamundësinë financiare të vëllait, Z.K., për të financuar blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, pasi Z.K. para se të blinte apartamentin në rrugën “{***}” në vitin 2011, dispononte me dokumentacion të paktën 50.000 euro të përdorura për tentativën e blerjes së një apartamenti në {***}, 2.348.676 lekë nga paga nga punësimi pranë {***} për periudhën 2008-2011 dhe 3000 euro gjendje në llogari pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë.

80.3. Konkluzioni i Komisionit i paraqitur në vendim në pikën 2 të tij, sipas të cilit nuk është provuar në mënyrë bindëse as kohëzgjatja e qëndrimit të z. Z.K. në Angli, as shumat e përfituara dhe as pagesa e tatimeve që mund të legjitimonte këto të ardhura, është konkluzion i gabuar sipas subjektit të rivlerësimit, pasi ai ka paraqitur mjaftueshëm prova në këtë drejtim.

80.4. Komisioni, në mënyrë të gabuar ka cilësuar si “gjetje” mendimin e vëzhguesit të ONM-së, duke i paracaktuar asaj vlerën e provës në kundërshtim me parashikimet e nenit 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, vlerësimin e çështjes mbi të ardhurat e fituara nga z. Z.K. në emigracion mbi bazën e këtij akti.

80.5. Komisioni, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, ka konstatuar në mënyrë të gabuar situatën faktike lidhur me punësimin e z. Z.K.

80.6. Konkluzioni i Komisionit i paraqitur në vendim, në pikën 2 të tij, sipas të cilit z. Z. K., në vitin 2011, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar një investim prej 10.888.000 lekësh, duke qenë se nuk kishte të depozituara në sistemin bankar shuma të mjaftueshme parash, si dhe se gjatë hetimit nuk rezultoi që ai të kishte qenë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit apo pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat apo publik, nga ku mund t'i kishte përfituar këto të ardhura, është i panevojshëm

dhe tendencioz, me qëllim rëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit dhe paraqitjen e shtrembëruar të fakteve nga ana e Komisionit.

80.7. Konkluzionet e aktit të përfundimit të kontrollit nga ana e ILDKPKI-së dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.11.2017, lidhur me të ardhurat e vëllait, z. Z.K., për periudhën deri në vitin 2011 dhe në vitin 2015, janë keqinterpretime tendencioze dhe janë trajtuar nga Komisioni pa asnjë hetim dhe verifikim.

- 81.** Trupi gjykues vëren se Komisioni, gjatë procesit të hetimit, referuar rezultateve të hetimit administrativ të njoftuara më datë 18.05.2018, në vlerësim të pasurisë së sipërcituar, ka konstatuar lidhjen mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, Z.K., në cilësinë e palëve të përfshira në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” në rrugën “{***}”, Tiranë, nga shitja e së cilës subjekti ka deklaruar se ka krijuar të ardhura, të cilat i ka përdorur për blerjen e truallit me sip. 146 m² në rrugën “{***}”, Tiranë. Për sa më sipër, Komisioni e ka kualifikuar vëllain e subjektit në cilësinë e personit tjetër të lidhur me të dhe i ka kaluar atij barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit:

◦ *Ngjan që të ketë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në dispozicion të z. Z.K., për të justifikuar një investim prej 10888.100 lekë në vitin 2011.*

- 82.** Në rezultatet e hetimit të njoftuara më datë 15.07.2018, pas rihapjes së tij për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni i ka përcjellë për dijeni subjektit edhe gjetjen e paraqitur nga vëzhguesi i ONM-së me nr. {***} prot., datë 04.10.2018, dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me rezultatit në vijim.

◦ *Vërtetësia e deklaratës mbi të ardhurat e z. Z.K. në Angli, siç është thënë/cituar në gjetjen e ONM-së, të sipërpërmendur, duket shumë e dyshimtë dhe, për rrjedhojë, duket i pajustificuar burimi i të ardhurave me të cilat z. Z.K. ka kryer blerjen/pagesën e apartamentit tuaj, me sipërfaqe 84 m², në rr. “{***}, me çmimin 10888.100 lekë, më datë 11.11.2011, si dhe apartamentin dhe garazhin, të blerë në emër të babait tuaj, nga shoqëria “{***}” ShPK, respektivisht me sipërfaqe 135 m² dhe 18 m², në rrugën “{***}”, me çmim apartamenti 59400 euro sipas kontratës së porosisë rep. {***}, kol. {***}, datë 15.10.2004 dhe 10000 euro garazhi, sipas kontratës me rep. {***}, kol. {***}, datë 23.01.2007.*

- 83.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, si më poshtë.

(i) *Komisioni e konsideron si detyrë e tij të administrojë, shqyrtojë, vlerësojë dhe përdorë të gjithë dokumentacionin apo informacionin që ka lidhje me objektin e çështjes në shqyrtim, dhe natyrisht përfshirë këtu edhe provat e paraqitura vullnetarisht nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit të tij.*

(ii) *Kështu që, për sa i përket detyrimit ligjor ose jo për të dhënë shpjegime apo prova nga vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit, mbi ligjshmërinë e burimit të pasurive të tyre si persona të tjerë të lidhur, Komisioni çmon që trupi gjykues jo vetëm që mund, por ai duhet të analizojë dhe të përdorë - kur e vlerëson të dobishme në funksion të vendimmarrjes - çdo provë që është paraqitur, që është marrë apo që ka mbërritur pranë tij, përfshirë këtu edhe ato që janë paraqitur prej vetë z. Shpëtim Kurti ose nga vëllai i tij përgjatë hetimit administrativ.*

(iii) *Kështu që, fokusimi tek ekzistenca apo jo e detyrimit në ngarkim të personave të tjerë të lidhur, për të dhënë shpjegime, nuk duket e rëndësishme në këtë moment dhe rrethanë, për aq kohë sa – siç u tha edhe më lart – edhe në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm të pasurive të personave të tjerë të lidhur, Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur*

nga vetë subjekti i rivlerësimit, përkrah të gjitha deklarimeve të tjera, dokumenteve dhe informacioneve të administruara prej tij, tërësisht në respekt të dispozitave që rregullojnë procedurat e marrjes së provave; [...]

*(iv) Kjo do të thotë që subjekti ka paraqitur si provë një dokument joautentik, për sa u arsyetua edhe më lart dhe, për rrjedhojë, rezulton qartë se ka dështuar tentativa e kryer nga subjekti i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave – në kuptimin e ligjit nr. 84/2016 - të vëllait të tij, me të cilat ai ka investuar për blerjen e vitit 2011, të apartamentit pikërisht të subjektit të rivlerësimit. Dhe për rrjedhojë, ka dështuar të provojë edhe burimin e ligjshëm në origjinë, për sa i përket investimit të kryer nga vetë z. Shpëtim Kurti në vitin 2012 për blerje të truallit me sip. 146 m² dhe të ndërtesës me sip. 52 m², pasi ai është deklaruar në “vetting” si burim financiar i realizuar me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të tij, ndodhur në rr. “{***}” (tek vëllai). Ai gjithashtu ka munguar të provojë dhe të japë shpjegime të besueshme mbi burimin e ligjshëm të pasurive dhe ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë në posedim (neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës). Si konkluzion, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të këtij aseti, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

84. Në kuadër të vlerësimit të shkaqeve të ankimit të parashtruar nga subjekti i rivlerësimit sipas nënparagrafëve 80.1 - 80.7 më sipër, pas verifikimeve të kryera në fashikullin e Komisionit dhe analizimit të hetimeve të kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri të deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe arsyetimit të dhënë në vendimin përfundimtar, trupi gjykues konstaton fillimisht se vendimmarrja e Komisionit, sipas së cilës subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë truall me sip. 146 m², ka ardhur si rrjedhojë e dështimit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait, z. Z.K., për financimin e blerjes së pasurisë së paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, “apartament banimi” në rrugën “{***}”, Tiranë, një pjesë e të ardhurave të përfituara prej së cilës janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e tokës truall me sip. 146 m² në rrugën “{***}”, Tiranë.
85. I gjithë arsyetimi i Komisionit në vendimin e tij rreth kësaj pasurie, edhe pse konstatohet se nuk u është referuar në mënyrë të shprehur parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është orientuar rreth kësaj dispozite ligjore dhe detyrimit që ajo përcakton për subjektet e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me ta, “justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijuar të pasurive”.
86. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij provohet ekzistenca e lidhjes së interesit, në kuptim të përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sip. 83,7 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me kontratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 11.11.2011, para noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë, D.K. Sipas kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e shitësit i ka kaluar pronësinë e apartamentit z. Z.K., i cili në cilësinë e blerësit i ka paguar subjektit të rivlerësimit, sipas referencës në kontratë, çmimin e blerjes prej 10888.000 lekësh. Për rrjedhojë, në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se me të drejtë Komisioni e ka kualifikuar vëllain e subjektit si “person tjetër të lidhur”, në kuptim të dispozitës ligjore të sipërcituar dhe në drejtim të sa më sipër ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të qartësimit të rrethanave konkrete në të cilat ka ndodhur transaksioni i shitblerjes mes palëve, të ardhurat e krijuara prej së cilës kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së paluajtshme “tokë truall” me sip. 146 m²

në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe për krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit likuiditet në llogari rrjedhëse” në shumën 58.000 euro pranë Raiffeisen Bank.

87. Megjithatë, trupi gjykues, referuar përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e dhurimit, huadhënies ose huamarrjes nga personat e tjerë të lidhur, vlerëson se lidhja e interesit që ka ekzistuar mes palëve kontraktuale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme në vitin 2011, nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozita e sipërcituar, në kuptim të së cilës të mund ta kualifikonte z. Z.K. si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, ta ngarkonte atë dhe subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave me anë të të cilave është financuar transaksioni i shitblerjes së apartamentit të banimit në rrugën “{***}”. Ky qëndrim është tashmë i konsoliduar referuar jurisprudencës së Kolegjit në trajtimin e çështjeve të ngjashme.
88. Edhe pse në vijim të sa më sipër, argumenti i subjektit të rivlerësimit dhe pretendimi i ngritur në shkakun e ankimit të parashtuar në nënparagrafin 80.1 vlerësohet i bazuar, Kolegji çmon se referuar (i) konstatimit në raportin përfundimtar të ILDKPKI-së se subjekti ka kryer deklaram të rremë të shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, me sipërfaqe 83,7 m², në shumën 10888000 lekë, me qëllim krijimin e burimeve financiare të cilat janë përdorur prej subjektit në vijim, (ii) të dhënave të konstatuara nga rezultatet e hetimit të Komisionit, si pasojë e të cilave ngrihen dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe raportin real të tij me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” në rr. “{***}”¹⁸, (iii) faktit se nga hetimi i Komisionit mjaftueshmëria e burimeve financiare të blerësit (vëllait të subjektit të rivlerësimit) nuk u arrit të provohet, për më tepër që lidhur me transaksionin e shitblerjes së apartamentit në vitin 2011, nuk është administruar asnjë provë apo qoftë edhe indicie në drejtim të qarkullimit të vlerës monetare nga blerësi të shitësi – trupi gjykues vlerëson se transaksioni i shitblerjes dhe të ardhurat e krijuara prej tij që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tjera të subjektit të rivlerësimit, nuk arrijnë nivel besueshmërie.
89. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni do duhej të kishte bërë kualifikim të ndryshëm juridik të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ në kuadër të arritjes së një përfundimi të drejtë lidhur me verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit mbi shitjen e apartamentit të banimit në rr. “{***}”, në vlerën e 10888000 lekëve dhe verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurive të tjera në vijim, me burim të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti.

¹⁸ Trupi gjykues konstatoi se në tri dokumentacione (Aktet për Emigracionin) të përcjella në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht: (i) Njoftim për seancë gjyqësore (2 dokumente); (ii) Njoftim për apelim të pazgjidhur, të tria këto akte të datës 25 maj 2006, të dhënat me të cilat referohet adresari janë: Z.K., rruga “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë, Shqipëri, ndërkohë që subjekti dhe vetë z. Z.K. janë shprehur se në vitin 2004, z. Z.K. ka financuar blerjen prej të atit të apartamentit të tij në rrugën “{***}”, e cila logjikisht mund të shërbente edhe si adresë kontakti e këtij të fundit. Në të njëjtën linjë me sa më sipër, u konstatua se në kontratën noteriale për shitblerjen e apartamentit të banimit, me sip. 64 m² në Durrës, z. Z.K. në nëntor të vitit 2010, në të dhënat e identifikimit të tij si palë kontraktuale, shfaqet me banim në adresën: lagja {***}, rr. “{***}”, pall. {***}, shk. {***}. Gjithashtu, edhe në kontratën noteriale të shitblerjes së vetë apartamentit objekt shqyrtimi, sipas kontratës me nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 11.11.2011, me të cilën po kalohej pronësia e apartamentit në rrugën “{***}”, z. Z.K. si palë blerëse identifikohet në kontratë si banues në këtë apartament, ndërkohë që z. Shpetim Kurti si shitës i apartamentit në fjalë identifikohet me banim në rrugën “{***}”.

90. Në vijim të përfundimeve të arritura si më sipër, lidhur me shkakun e ankimit në nënparagrafin 80.1, trupi gjykues çmon të panevojshëm arsyetimin lidhur me shqyrtimin e shkaqeve të tjera të ankimit lidhur me pasurinë “tokë me sip. 146 m²”, si dhe me pasurinë e llojit “likuiditet në llogari rrjedhëse” në shumën 58.000 euro pranë Raiffeisen Bank, për sa kohë ato lidhen ngushtësisht me përfundimin e arritur nga Komisioni, sipas të cilit subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të këtyre pasurive, si rrjedhojë e dështimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait, z. Z.K., për financimin e blerjes së pasurisë së paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, “apartament banimi”, në rrugën “{***}”, Tiranë, konkluzion ky i cili u gjet i pabazuar nga ana e trupit gjykues në raport me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
91. *Lidhur me përdorimin e apartamentit të babait të subjektit të rivlerësimit, z. M.K., pa pagesë qiraje, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 ka kualifikuar si “person tjetër të lidhur” babain e tij, z. M.K., duke i ngarkuar atij detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurisë, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe pse ai nuk ndodhet në një marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, si ato të përcaktuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar.*
92. Lidhur me përdorimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të banesës së babait të tij për banim, pa qira, Komisioni në përfundim të procesit të rivlerësimit ka arsyetuar në vendimin e tij, ndër të tjera, si më poshtë:
- [...] d) Për rrjedhojë, në saje të analizës dhe arsyeve të kryera në pikën 3 (pararendëse), konstatohet dhe konkludohet se edhe në këtë rrethanë ka pasur mungesa të burimit të ligjshëm, me të ardhura të pamjaftueshme për të justifikuar investimet e sipërcituara, të kryera nga z. M. K. Konkretisht, ky konkluzion arrihet në bazë të sa u konstatua edhe më sipër, lidhur me pavërtetësinë e deklaratës së paraqitur si të lëshuar nga “{***}”, pra në saje të dështimit të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumave të pretenduara si të fituara dhe të kursyera nga z. Z. K., në Angli.*
- e) Edhe në lidhje me këtë pikë, konsiderohen si të ripërmendura qëndrimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe arsyetimet dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni, të paraqitura në pikën e mësipërme (nr. 3), pasi burimi i pretenduar i të ardhurave është i njëjti (puna në Angli e z. Z. K.) dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, si tentativë për të provuar burimin e ligjshëm financiar në fjalë, janë po ato të shqyrtuara më lart.*
93. Nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se analiza ligjore e Komisionit në këtë rast është sipërfaqësore dhe mbi të gjitha, edhe pse duket sikur Komisioni u qëndron në trajtimin e këtij rasti konkluzioneve të arritura në pikën 3 të vendimit të tij (që i takojnë vlerësimit të kursimeve në formën e likuiditetit, në vlerën prej 58.000 eurosh), mbetet e paqartë se cila është pasoja ligjore që i atribuohet subjektit të rivlerësimit në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm për rivlerësimin kalimtar, në rastin në fjalë, kur Komisioni, për analogji me trajtimin e çështjes së kursimeve, ka arritur në konkluzionin se banesa e babait të subjektit të rivlerësimit, në të cilën ky i fundit ka deklaruar se jeton përkohësisht, nuk mund të justifikohet me burime të ligjshme.
94. Në analizë të fakteve dhe rrethanave lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të të apartamentit të babait të tij, z. M.K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M.K., si më sipër, mund të trajtohej teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në

përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 135 m² dhe dy garazhe me sip. 18 m², subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit.

95. Ndërkohë që, referuar arsytimit të Komisionit në vendim, në rastin konkret nuk ka qartësi për trupin gjykues nëse Komisioni ka bërë një vlerësim të kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës (tentativës për të fshehur pasurinë), në konsideratë edhe të (i) konstatimit në raportin e ILDKPKI-së për fshehje të pronësisë dhe burimit real të vlerës së pasurisë prej 69.400 eurosh, pa përfshirë shpenzimet për mobilimin e shtëpisë të deklaruar nga subjekti në pronësi të babait; (ii) konstatimeve nga vetë Komisioni në rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë lidhur me deklaratimet kontradiktore¹⁹ mbi periudhën/vitin në të cilin subjekti dhe familja e tij kanë filluar të jetojnë në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe periudhën e gjatë kohore të përdorimit të banesës së të atit; (iii) faktit të blerjes prej të atit të subjektit të rivlerësimit të dy garazheve, ndërkohë që ai nuk rezulton të ketë pasur automjet në pronësi, në kohën e blerjes dhe në periudhat në vazhdim; si dhe (iv) denoncimeve të ardhura nga publiku.
96. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit në vendim, lidhur me përcaktimin e situatës faktike të marrëdhënies reale të subjektit me këtë pasuri të paluajtshme, është i paqartë, për shkak të një hetimi të paplotë, dhe kualifikimi ligjor i fakteve të rezultuara nga procesi i hetimit administrativ nuk është i saktë, pasi nuk është orientuar nga nevoja për të verifikuar marrëdhënien reale të subjektit të rivlerësimit me banesën e babait të tij.
97. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni në trajtimin e këtij kriteri nuk ka konstatuar në mënyrën e duhur dhe të plotë situatën faktike, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Për pasojë, lidhur me këtë kriter, trupi gjykues vlerëson se arsytimi i Komisionit është sipërfaqësor dhe i paqartë. Sa më sipër, arrihet në përfundimin se shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë mund të kryhet vetëm nëpërmjet një hetimi të plotë dhe rikonstatimit nga Kolegji të situatës faktike në seancë publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit, duke i garantuar këtij të fundit të drejtën për t’u dëgjuar.
98. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në vijim të arsytimit të trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës, u vërtetua se nuk ka nivel të besueshëm lidhur me këtë kriter rivlerësimi dhe, si pasojë, nuk është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, trupi gjykues çmon se, për arsye të ekonomisë gjyqësore, shqyrtimi i shkaqeve të ankimit për kriterin e

¹⁹ Referuar rezultateve të hetimit kryesisht, Komisioni i ka konstatuar subjektit deklaratimet kontradiktore si më poshtë:

a) në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2009, në faqen 2, ju deklaroni për herë të parë vendbanimin tuaj, pikërisht në banesën e babait tuaj, në rr. “{***}”, në Tiranë;

b) në deklaratën “vetting”, të dorëzuar në fillim të vitit 2017, ju deklaroni që keni filluar të banoni te shtëpia e babait tuaj në rrugën “{***}”, në Tiranë (vetëm) prej vitit 2011, ndërsa në deklaratën e bërë në DSIK, më datë 23.01.2017, shtojca 3, pjesa e dytë, në faqen nr. 3, ju deklaroni që keni filluar të banoni në rr. “{***}”, nd. {***}, ap. {***} qysh prej vitit 2008.

pasurisë në seancë gjyqësore publike, është i panevojshëm, pasi në çdo rast vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra do të ishte i pacenueshëm dhe procesi i rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt mund të kryhet edhe vetëm mbi bazën e një kriteri rivlerësimi, atë të kontrollit të figurës.

99. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në konkluzionin:

Subjekti i rivlerësimit rezultoi me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, në kuptim të parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, duke e bërë atë të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti duhet të lihet në fuqi vetëm për sa i përket vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 61, pikat 2 dhe 3, 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 80, datë 23.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.06.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 07, datë 24.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nëpërmjet të cilit është vendosur unanimisht lënia në fuqi e vendimit nr. 80, datë 23.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mendimi im paralel/arsyetimi ndryshe nga shumica e anëtarëve të trupit gjykues në një pjesë të vendimit të themelit, është si më poshtë:

Nuk jam dakord me konkluzionin e paraqitur nga shumica e trupit gjykues në paragrafët nr. 97-98 të vendimit nr. 7, datë 24.06.2020, ku citohet shprehimisht:

97. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni në trajtimin e këtij kriteri nuk ka konstatuar në mënyrën e duhur dhe të plotë situatën faktike, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Për pasojë, lidhur me këtë kriter, trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i Komisionit është sipërfaqësor dhe i paqartë. Sa më sipër, arrihet në përfundimin se shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë mund të kryhet vetëm nëpërmjet një hetimi të plotë dhe rikonstatimit nga Kolegji të situatës faktike në seancë publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit, duke i garantuar këtij të fundit të drejtën për t’u dëgjuar.

98. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në vijim të arsyetimit të trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës, u vërtetua se nuk ka nivel të besueshëm lidhur me këtë kriter rivlerësimi dhe, si pasojë, nuk është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, trupi gjykues çmon se, për arsye të ekonomisë gjyqësore, shqyrtimi i shkaqeve të ankimit për kriterin e pasurisë në seancë gjyqësore publike, është i panevojshëm, pasi në çdo rast vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra do të ishte i pacenueshëm dhe procesi i rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt mund të kryhet edhe vetëm mbi bazën e një kriteri rivlerësimi, atë të kontrollit të figurës.

2. Nëse i referohemi vendimit të Komisionit, vendimmarrja për subjektin e rivlerësimit ka qenë lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, parashikuar nga neni D, pikat 1, 3, 5 dhe nga neni Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të çështjes, ka arritur në përfundimin se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë ka rezultuar sipërfaqësor dhe kualifikimi lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë në përputhje me dispozitat që parashikon Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
3. Ndodhur në këtë situatë, çmoj se detyra e Kolegjit është t’i evidentojë dhe korrigjojë gabimet, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon:
Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim.
4. Në kushtet kur Komisioni nuk ka kryer hetim administrativ të plotë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kushtet kur Kolegji mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit e ka pasur të

vështirë vlerësimin e këtij kriteri, për Kolegjin ka qenë i detyrueshëm kalimi i çështjes në seancë gjyqësore publike, kalimi i barrës së provës subjektivit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ dhe, në përfundim, vendimmarrja për kriterin e vlerësimit të pasurisë konform ligjit.

Edhe pse në nenin 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është shprehur qartë se *kur çështja është gati për t'u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm*, parashikimi ligjor më sipër nuk duhet të cenojë atë që është më e rëndësishme në procesin e rivlerësimit, zgjidhjen sa më drejt të çështjes objekt gjykimi, me qëllim që subjekti i rivlerësimit dhe publiku i gjerë të informohen saktë mbi argumentet ligjore që kanë çuar në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes.

5. Në rastin konkret, arsyetohet *se për ekonomi gjyqësore* mund të shmangen seancat dëgjimore joproductive etj., por jo të mos hetohet në mënyrë të plotë një kriter rivlerësimi, për të cilin trupi gjykues çmon se është hetuar në mënyrë sipërfaqësore nga Komisioni, i cili ka marrë vendim për këtë kriter, konkretisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Pavarësisht se në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*, sipas kësaj dispozite, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për tri kriteret dhe në momentin kur ka konstatuar probleme serioze lidhur me pasurinë dhe figurën, për arsye efikasiteti, ka marrë vendim vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, ndërkohë Kolegji në rastin objekt gjykimi ka dalë me vendim vetëm mbi kriterin e kontrollit të figurës.

6. Në përmbledhje të sa më sipër, shpreh mosdakordësinë me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues që për *ekonomi gjyqësore* të mos hetohet në mënyrë të plotë kriteri i vlerësimit të pasurisë sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, konkretisht të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi